

**STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR
SH.P.K**

ZOTËRIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, SELIA

**Neni 1
Ortakët**

1.1 Shoqëria Dominant ("Shoqëria") është themeluar në datën e shënuar në aktin e Themelimit nga Ortaku Themelues i mëposhtëm:

Z. Gazmend Veli, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, mbajtës i leternjoftimit nr. 035015852, madhor.

**Neni 2
Emri**

2.1 Emri i Shoqërisë është Dominant.

**Neni 3
Forma Ligjore**

3.1 Shoqëria ka formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë.


3.2 Shoqëria mund të transformohet në një formë tjetër ligjore në përputhje me legjislacionin shqiptar.

**Neni 4
Baza Ligjore**

4.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në përputhje me këtë Statut, Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ("Ligji Tregtar") dhe çdo dispozitë tjetër të zbatueshme të Legjislacionit shqiptar.

**Neni 5
Kohëzgjatja e Veprimtarisë**

5.1 Shoqëria krijohet për një afat të pacaktuar.



Neni 6
Selia/ Adresa e Regjistruar

6.1 Adresa e selisë së Shoqërisë është: Rr. "Neço Muka", Ndërtesa Nr. 9, Tiranë, Shqipëri.

Neni 7
Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë "Dominant" Sh.p.k

Shoqëria "Dominant" Sh.p.k do të ushtrojë aktivitetin e saj në sektorët e ndërtimit, pasurive të paluajtshme, tregtisë dhe konsulencës, duke përfshirë të gjitha proceset nga prodhimi deri te tregtimi dhe administrimi.

Aktivitetet kryesore

7.1 Tregtia dhe Shërbimet e Makinerive: Import, eksport, blerje dhe shitje të produkteve të lejuara nga ligji. Riparim, dhënie dhe marrje me qira të makinerive dhe pajisjeve të ndryshme.

7.2 Administrimi i Pasurive të Paluajtshme: Blerje, shitje, shkëmbim dhe valorizim i tokave, apartamenteve dhe ndërtesave. Dhënie dhe marrje me qira e ndërtesave dhe apartamenteve. Administrim dhe menaxhim i pasurive të patundshme, publike dhe private.


7.3 Ndërtim dhe Infrastrukturë: Ndërtim, rristrukturim, rindërtim dhe mirëmbajtje të objekteve civile dhe industriale. Realizim dhe mirëmbajtje të veprave infrastrukturore. Kryerje e punimeve të ndërtimit për sektorin publik dhe privat.

7.4 Investime dhe Operacione Financiare (jo ndaj publikut): Krijimi, blerja dhe administrimi i bizneseve në sektorët e tregtisë, industrisë, bujqësisë dhe shërbimeve., Investime në shoqëri të tjera duke respektuar kufizimet ligjore; Leasing (përfshirë qiradhënien financiare) dhe operacione financiare për nevoja të shoqërisë, Dhënia e garancive reale dhe personale për të tretët, brenda kufijve ligjorë.

7.5 Konsulencë dhe Trajnime: Konsulencë në bujqësi, blegtori, peshkim, ndërtim, tregti dhe sektorë të tjerë ekonomikë. Organizimi i trajnimeve dhe aftësimit profesional për specialistë të ndryshëm. Edukim dhe sensibilizim mbi shërbime të lidhura me sektorët e aktivitetit të shoqërisë.

7.6 Pjesëmarrje në Projekte dhe Tenderë Publikë: Aplikim dhe pjesëmarrje në tenderë dhe prokurime publike ose private. Bashkëpunim me ente dhe organizata për zbatimin e projekteve zhvillimore.

- Shoqëria ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimtaritë ndihmëse dhe plotësuese të nevojshme për realizimin e objektivit të saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- Shoqëria mund të mbështesë iniciativa sociale, edukative, kulturore, sportive dhe rekreative.
- Shoqëria mund të bashkëpunojë me ente publike dhe private për zbatimin e projekteve zhvillimore.



Neni 8 Kapitali

8.1 Kapitali i Shoqërisë është 1,000,000 (një milion) lekë.

8.2 Kapitali i Shoqërisë është i ndarë në 1 (një) kuotë me vlerë nominale 1,000,000 Lek per kuotë, dhe është paguar tërësisht si më poshtë nga:

Z. Gazmend Veli, shtetas shqiptar, lindur me Tirane, Shqiperi, mbajtes i leternjoftimit nr. 035015852, madhor, ka kontribuar në para në dorë në kapitalin e Shoqërisë një shumë të barabartë me 1,000,000 Lek e cila tashmë është paguar, dhe përfaqëson 1 kuotë të barabarta me 100% të kapitalit themeltar të paguar.

8.3 Në bazë të kontributeve të sipërcituara Z. Gazmend Veli zotëron 1 (një) kuotë, të barabarte me 100% (njëqind përqind) të kapitalit themeltar së shoqërisë.

Neni 9 Transferimi i pjesës së kapitalit/ Kufizimet në transferim

9.1 Ortaku është zotëruar i vetëm i të gjitha kuotave të kapitalit të regjistruar.

9.2 Kuotat e kapitalit të regjistruar mund të transferohen, tërësisht ose pjesërisht, tek të tretë vetëm me shkresë me shkrim

Neni 10 Rritja e kapitalit

10.1 Ortakët mund të rrisin kontributin e tyre në kapitalin e regjistruar.

10.2 Rritja e kapitalit mund të realizohet edhe përmes nënshkrimit të kuotave të reja të emetuara nga Shoqëria nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj do të pranohen dhe të miratohen si të tillë me një vendim të Ortakut të Vetëm.

Neni 11 Zvogëlimi i Kapitalit

11.1 Bazuar në vendimin e Ortakëve, zvogëlim i kapitalit të regjistruar do të bëhet në përputhje me procedurat e parashikuara nga legjislacioni tregtar

STRUKTURA DREJTUESE

Neni 12 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve

12.1 Vendimet kryesore të veprimtarisë së Shoqërisë miratohen me vendim të Ortakëve të cilët janë organi më i lartë drejtues i Shoqërisë, që ka të drejtën të miratojë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e aktivitetit të saj. Vendimi i Ortakëve duhet të regjistrohet në regjistrin e vendimeve të Shoqërisë në mënyrë që të dhënat të mos ndryshohen apo fshihen.



12.2 Vetëm Asambleja e Ortakëve do të kenë të drejtë të vendosin për çështjet e mëposhtme:

- a. modifikimin dhe ndryshimin e Statutit;
- b. pranimin e ortakëve të rinj (pas rritjes së kapitalit të regjistruar ose transferimit të kuotave);
- c. të rrisë dhe/ose zvogelojë kapitalin e regjistruar;
- d. vendosë për shkrirjen, prishjen, likuidim dhe/ose çdo lloj transformimi tjetër të Shoqërisë;
- e. të vendosë për përvetësimin dhe/ose në transferimin e pjesëmarrjeve në Shoqëri në Shqipëri apo jashtë saj;
- f. të themelojë dhe/ose të mbyllë degë ose zyra përfaqësimi;
- g. të miratojë raportet vjetore dhe bilanci dhe të miratojë shpërndarjen e fitimit;
- h. të miratojë rregullat e brendshme të administrimit;
- i. të depozitojë padi kundër anëtarëve të organeve të Shoqërisë;
- j. të vendosë mbi përvetësimin, shitjen dhe vendosjen e barrës mbi pasuritë e paluajtshme;
- k. të prishë Shoqërinë;
- l. të vendosë pagën e Administratorit;
- m. të vendosë për caktimin e ekspertëve kontabël;
- n. të miratojë emërimin e audituesve;
- o. të vendosë mbi organizimin strukturor dhe administrativ të Shoqërisë;
- p. të vendosë mbi punësimin, shkarkimin dhe mbi çdo çështje tjetër të lidhur me punësimin si promovime, bonuse etj të cilat i përkasin pozicioneve drejtuese në Shoqëri;
- q. të miratojë hua ose dhënie të titujve;
- r. të vendosë për çdo çështje tjetër që i takon për zgjidhje mbledhjes së aksionarëve, me ligj dhe/ose sipas këtij Statuti.

Neni 13

Administrimi i Shoqërisë

13.1 Në të gjithë veprimtarinë brenda dhe jashtë vendit Shoqëria përfaqësohet nga secili prej Administratorit(ëve) që emërohen dhe zëvendësohen prej Ortakëve.

13.2 Administratori(ët) do të kenë kompetenca të plota për drejtimin e zakonshëm dhe të përditshëm të Shoqërisë dhe aftësinë për të miratuar të gjitha vendimet që i konsiderojnë të përshtatshme për të arritur dhe zbatuar objektin e Shoqërisë, me përjashtimin e vetëm të veprimeve që sipas ligjit, këtij Statuti ose vendimeve të herë pas herëshme të Ortakëve i takojnë Asamblese së Ortakëve.

13.3 Administratori(ët) kanë të drejtë të delegojnë nëpërmjet prokurës, pjesërisht ose plotësisht kompetencat e tyre një personi të tretë sipas miratimit paraprak me shkrim të Ortakëve. Administratori i shoqërisë mëmë nuk mund të caktohet si Administratori i një shoqërie të kontrolluar dhe anasjelltas.

13.4 Me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë Statut, Administratori(ët) kanë të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:

- administrimin e përditshëm të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë në përputhje me vendimet dhe udhëzimet e Ortakëve, sipas rastit, të miratuara herë pas here;
- përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe organeve publike;
- hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë në banka;
- lidhjen e marrëveshjeve me palë të treta;
- lëshimin e faturave, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë;
- punësimin dhe shkarkimin e punonjësve të Shoqërisë dhe përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të punonjësve në përputhje me politikat dhe udhëzimet e miratuara, herë pas here, nga Ortakët;
- kryerjen e të gjitha veprimeve të tjera që i takojnë aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- mbajtjen e librave kontabël në përputhje me ligjin dhe parimet e kontabilitetit;
- përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të Shoqërisë dhe auditimin e tyre nga ekspertë kontabël të jashtëm nëse kjo kërkohet nga ligji ose me vendim të Asamblese së Ortakëve.

13.5 Administratorët do të ushtrojnë detyrat e tyre deri sa të zëvendësohen në përputhje me 13.1 më sipër, por në çdo rast jo më shumë se 5 vjet, me të drejtë ri-emërimi. Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, Administratori(ët) duhet të tregojnë kujdesin e një personi të ndërgjegjshëm dhe të besueshëm dhe do të ruajnë fshehtësinë për çështjet konfidenciale.

13.6 Administratori i parë i Shoqërisë, i emëruar për një periudhë 5 vjeçare është:

- Z. Gazmend Veli, shtetas shqiptar, lindur me Tirane, Shqiperi, mbajtes i leternjoftimit nr. 035015852, madhor

Neni 14

Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësitë

14.1 Përveç detyrimeve të përgjithshme të parimit të besnikërisë të parashikuar në nenet 13,14, 15, 17 dhe 18 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Administratori (ët) duhet:

- a. të kryejë detyrat e tyre në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare apo këtë Statut në mirëbesim dhe duke marrë parasysh interesat e Shoqërisë si e tërë, dhe ne vecanti duke konsideruar ndikimin në mjedis të veprimtarisë së saj
- b. të ushtrojë kompetencat e tyre të caktuara prej Ligjit për Shoqëritë Tregtare apo këtij Statuti, vetëm për qëllimet e paracaktuara aty;
- c. të konsiderojë në mënyrë të përshtatshme çështjet për të cilat duhet të vendoset;
- d. të parandalojë dhe të shmangë konflikte potenciale ndërmjet interesave personale dhe atyre të Shoqërisë;
- e. të ushtrojë detyrat e tyre sipas parimit të kujdesit dhe të profesionalizmit
- f. të vërë në dispozicion çdo informacion në lidhje me biznesin dhe të dhënat ekonomike të Shoqërisë të kërkuar nga secili prej ortakëve, brenda një afati kohor të përshtatshëm dhe në çdo rast jo më vonë se 7 ditë. Informacioni dhe të dhënat duhen përditësuar.

14.2 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, Administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme:

- a. u kthejnë anëtarëve kontributet;
- b. u paguajnë anëtarëve interesa apo dividendë.
- c. shpërndajnë aktivet shoqërisë.
- d. lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e. japin kredi.

Neni 15

Eksperti(ët) Kontabël të Autorizuar

15.1 Eksperti(ët) Kontabël i Autorizuar do të emërohet me vendim të Ortakëve, nëse është e nevojshme.

Neni 16

Viti Financiar

16.1 Viti Financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 17

Bilanci. Mbajtja e Llogarisë

17.1 Bilanci i Shoqërisë shqyrtohet nga Ortakët dhe duhet të përgatitet për t'ju paraqitur organeve tatimore përpara përfundimit të muajit mars të vitit pasardhës.

17.2 Librat e llogarisë duhet të mbahen në gjuhën shqipe dhe në monedhën vendase (lekë). Shoqëria mund të mbajë llogari të vecanta në monedhë të huaj.

17.3 Shoqëria mund të marrë financime nga institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë arsye Shoqëria mund të vendosë barrë siguroese mbi kuotat si garanci, ose mund të hipotekojë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të saj me vendim të Ortakëve.

Neni 18

Likuidimi

18.1 Ortakët mund të vendosin të prishin Shoqërinë.

18.2 Me vendim të Ortakëve do të caktohet një likuidues ose një grup likuiduesish që do të merren me procedurat e likuidimit.

18.3 Likuidues(it) do të përgatisin raportin e likuidimit, i cili përmban një përmbledhje të gjendjes ekonomike të Shoqërisë, hapat e likuidimit, dhe me pas Ortaket do të kontrollojnë bilancin përfundimtar dhe do të japin miratimin për përfundimin e procedurës së likuidimit

Neni 19

Ndryshimet në Statut

19.1 Dispozitat e këtij Statuti mund të ndryshohen nga Asambleja e Ortakëve, në përputhje me dispozitat e legjisllacionit tregtar



Neni 20
Dispozita Përfundimtare

Ky statut është hartuar në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Neni 21
Vula dhe Logo

21.1 Shoqëria "DOMINANT" Sh.p.k

- Shoqëria "DOMINANT" Sh.p.k ka të drejtë të përdorë një vulë dhe një logo të regjistruar, të cilat do të identifikojnë shoqërinë në veprimtarinë e saj tregtare dhe administrative.
- Logoja dhe vula e shoqërisë janë pronë ekskluzive e saj dhe mund të përdoren vetëm për qëllime zyrtare dhe në përputhje me interesat e shoqërisë.
- Çdo ndryshim në logon ose modelin e vulës duhet të miratohet nga ortakët i vetëm ose nga asambleja e ortakëve, sipas rastit.

Administratori përgatit dhe prodhon vulën dhe logon e shoqërisë jo më vonë se 30 ditë nga regjistrimi i shoqërisë në QKB.

- Administratori është përgjegjës për ruajtjen dhe përdorimin e vulës dhe logos së shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore dhe statutin.
- Administratori ka detyrën të sigurojë që vula dhe logoja të përdoren vetëm për dokumente dhe veprime zyrtare të shoqërisë, duke shmangur çdo përdorim të paautorizuar ose të paligjshëm.
- Administratori mund të autorizojë persona të caktuar për të përdorur vulën, vetëm për veprime të përcaktuara qartë dhe të miratuara nga ai.

Në rast humbjeje, dëmtimi ose keqpërdorimi të vulës apo logos, administratori është i detyruar të ndërmarrë masa të menjëhershme, duke njoftuar organet kompetente dhe duke marrë masa për zëvendësimin ose mbrojtjen e të drejtave të shoqërisë.

Neni 22
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis Ortakëve

Negocimi dhe Zgjidhja e Brendshme

- Ortakët angazhohen të zgjidhin çdo mosmarrëveshje nëpërmjet negociatave të drejtpërdrejta dhe në mirëbesim, duke pasur parasysh interesin më të mirë të shoqërisë.

Ndërmjetësimi

- Nëse mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet me negociatë të drejtpërdrejta brenda 30 ditëve, palët bien dakord të kërkojnë ndërmjetësim nga një palë e tretë e paanshme, e cila mund të jetë një ekspert ligjor ose financiar i pranuar nga të dyja palët.

Arbitrazhi

- Nëse ndërmjetësimi nuk sjell një zgjidhje të pranueshme, mosmarrëveshja do t'i referohet një tribunali arbitrazhi sipas rregullave të Qendrës Shqiptare të Arbitrazhit ose një organi tjetër të dakordësuar nga ortakët.
- Vendimi i arbitrazhit për të cilin palët kishin mosmarrëveshje dhe janë dakordësuar është përfundimtar dhe detyrues për palët.



Gjykata Kompetente

- Nëse asnjë nga metodat e mësipërme nuk sjell një zgjidhje ose në rastet kur njëra palë nuk respekton vendimin e arbitrazhit, pala e dëmtuar ka të drejtë t'i drejtohet gjykatave kompetente në Shqipëri për zgjidhjen përfundimtare të çështjes.
- Ruajtja e Funksionimit të Shoqërisë

Gjatë kohëzgjatjes së mosmarrëveshjes, ortakët janë të detyruar të mos dëmtojnë funksionimin normal të shoqërisë dhe të shmangin veprimet që mund të dëmtojnë interesat e saj.

Tirane, me 03.03.2025

Ortaku Themelues

Gazmend Veli

